



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/01-2209 dt. 25/04/2019

Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- z.Labinot Halilaj

Për: Kryetarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt : 25.04.2019

1. Vendim për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin " Fehmi Lladrovci" i plotësuar.
2. Vendim për lejimin e rrënitit të objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale në Drenas, ish objekti për sigurime sociale, i plotësuar.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12-Nr 354-22099 dt. 25.04.2019

Duke u bazuar në nenin 11, 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 paragrafi 1.5, nenit 14 paragrafi 3 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim, Vendimit Nr.08-070-20307, të datës 16.04.2019 për Leje Rrënimi të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, nenit 98 të Statutit të Komunës së Gllogocit, kërkesës së drejtorisë së Inspeksionit Nr. 11-354-15308, të datës 20.03.2019, si dhe në bazë të kërkeses për rishqyrtim të vendimit nr:020-310/13 të datës; 12.04.2019, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.04.2019 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për lejimin e rrënitit të objekti që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale Drenas, ish objektit për sigurime sociale, i plotësuar

Neni I

Me këtë Vendim, kërkohet që të na lejohet rrënimi i objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale Drenas, ish objektit për sigurime sociale.

Neni II


Rrënimi i objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale Drenas, ish objektit për sigurime sociale, do të mbikëqyret nga ana e personave përgjegjës në Komunën e Drenasit .


Neni III

Të gjitha shpenzimet e rrënitit për objektin e lartcekur, do të bien në drejtorinë e Inspeksionit.

Neni IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlersimit të ligjshmerisë nga
MAPL-ja dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës

 Kryesuesi / Kryençit të Komunës
Labib Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 08.05.2019

Nr.020-459/5

Për: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit
Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit

Lënda: Shkresë përcjellëse

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar, Vendimin Nr.354-22099 për lejimin e rrënimt të objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale Drenas, ish objektit për sigurime sociale, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit dhe nënshkruara nga Kryesuesi i KK të Glllogocit, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 26.04.2019, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.


Bashkangjitur gjeni Raportin nga MMPH lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

Me respekt,

Rozafa Ukimeraj

sekretarë e Përgjithshme e MAPL-së

Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Aeriana Hoxhiq, Ministre në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Cc:	Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Përmes:	Fatmir Matoshi, Minister i MMPH-së Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
Nga:	Vlora Osaj, u.d. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

E nderuar Ministre,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Drenasit 12 Nr. 354-22099 datë 25.04.2019, për lejimin e rrënimin të objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadasrale Drenas, ish objekti për sigurime sociale.
I miratuar me datë: 25.04.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 25.04.2019
I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 26.04.2019

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr -060/p/- 22021 dt. 25/04/ 2019

Duke u bazuar në nenin 11, 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nenit 14 paragrafi 1 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 pika 1.2 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, nenit 3 pika 1.14 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim, Aktvendimit për leje të lokacionit për vendosjen e shtatoreve të Heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci" në Drenas Nr.08-353-201470, të datës 16.04.2019, të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Raportit Nr.01-353-20569, të datës 17.04.2019 të komisionit për përcaktimin e lokacionit për vendosjen e shtatoreve të heronjve, nenit 98 të Statutit të Komunës së Glllogocit, si dhe ne bazë të kërkesës për rishqyrtim të ligjshmërisë nga MAPL me nr:020-310/16 të datës 12.04.2019 Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.04.2019 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci", i plotësuar

Neni I

Me këtë Vendim, kërkohet që të na lejohet vendosja e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci"

Neni II


Vendosja e shtatoreve do të bëhet brenda sheshit "Fehmi Lladrovci" në lokacionin e përcaktuar nga ana e komisionit, i cili do të merret me caktimin e lokacionit për vendosje të shtatoreve.


Neni III

Të gjitha shpenzimet sikurse për punimin e shtatoreve ashtu edhe për vendosjen e bazamenteve do të bëhet me anë të donacioneve.

Neni IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlersimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës

 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 30.04.2019

Nr.020-459/3

Për: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit
Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit

Lënda: Shkresë përcjellëse

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar, Vendimin Nr.12-060/01-22091 për vendosjen e shtatoreve të heronjëve Shaban Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci" i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit dhe nënshkruara nga Kryesuesi i KK të Glllogocit, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 26.04.2019, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.


Bashkangjitur gjeni Raportin nga MMPH lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

Me respekt,

Rozafa Ukimeraj
Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së


Begolli

Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitërim të Komunave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning



Për :	Adriana Hoxhiq, Ministre në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Ce:	Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	
Përmes:	Faimir Matoshi, Minister i MMPH-së Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së	
Nga:	Vlora Osaj, u.d. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Data: 26.04.2019
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë	
Eloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

Ë nderuar Ministre,
Ë nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Drenasit 12 Nr. 060/01-2209I datë 25.04.2019, për vendosjen e shitoreve të heronjëve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin „Fehmi Lladrovci”.

I miratuar me datë: 25.04.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 25.04.2019

I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 26.04.2019

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të nevojshëm në lidhje me këtë vlerësim.